

**LIGJ**  
**Nr. 140/2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 155/2015 “PËR LOJËRAT E FATIT NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 7, pika 4, fjalët “31 dhjetor 2016” zëvendësohen me fjalët “31 dhjetor 2018”.

Neni 2

Në nenin 9 bëhet ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ndalohet reklamimi i aktivitetit të lojërave të fatit, në pjesën e jashtme të pikave/sallave të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori, sipas këtij ligji, me përjashtim të tabelës identifikuese. Formatit dhe përmasat e tabelës identifikuese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Brenda një periudhe njëmuajore nga hyrja në fuqi e udhëzimit, organizatorët e lojërave të fatit marrin masat për zbatimin e këtij detyrimi. Në rast se brenda kësaj periudhe organizatorët nuk kanë marrë masat për ndryshimin e formatit dhe përmasave të tabelave identifikuese, sipas këtij udhëzimi, zbatohen masat administrative të parashikuara në nenin 53 të këtij ligji.”

2. Në fjalinë e dytë të pikës 6, fjalët “si dhe gjatë emisioneve sportive” hiqet.

Neni 3

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Formatit dhe përmasat e tabelave identifikuese në pjesën e jashtme të pikave/sallave të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave që miratohet brenda datës 31 janar 2017.”

2. Kudo në këtë nen fjalët “brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31 janar 2017”.

Neni 4

Në nenin 71 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organizatorët e kazinove elektronike dhe bingoje tradicionale, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë të drejtë të ushtrjnë aktivitetin vetëm në pikat që janë hapur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në datën 31 dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe tranzitore nuk lejohet hapja e pikave të reja sekondare për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëritë e licencuara për kazino elektronike dhe bingo tradicionale. Pikat që mbyllen për këto kategori gjatë periudhës tranzitore nuk mund të rihapen.”

2. Në pikën 3, fjalët “31 dhjetor 2016” zëvendësohen me fjalët “31 dhjetor 2018”.

Neni 5

Në nenin 72 bëhet ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i fundit i pikës 4.2 shfuqizohet.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Organizatorët e lojërave të fatit, sipas kategorive përkatëse, derdhen në llogari të ministrisë përgjegjëse për sportin, ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin shumë përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 52 të këtij ligji.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 22.12.2016